



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.45/2019

Prishtinë, më 11 shkurt 2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Mexhide Mjaku-Topalli, Saranda Bogujevci, dhe Veton Berisha.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Bahri Hyseni-KPK, Valdrin Krasniqi-KPK, Nehat Idrizi-KGJK, Drita Vitia-Radio Kosova, Shkelqim Mehmeti-KDI, Rabije Kryeziu-RTK, Besiana Dauti-Kosova Press, Arbisa Shefkiu-Klan Kosova, Jelena Gjorgjeviq-RTK 2, Emine Jakupi- praktikante, Fitore Ademi-RTV21.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit propozuan që si pikë e rendit të ditës të jetë edhe pika nr. 2. Të ndryshme, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë.

Rend të ditës:

1. Diskutim në Komisionin Funkcional me përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me ngjarjet e fundit të dhunimit të nxënëses nga Drenasi
2. Të ndryshme.

1. Diskutim në Komisionin FunkSIONAL me përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me ngjarjet e fundit të dhunimit të nxënësës nga Drenasi

Kryetarja, tha se rasti fundit që ka ndodhur me një vajzë nga Drenasi, është shqetësues për të gjithë ne dhe sipas mediave për dy vite, në Kosovë kanë ndodhur 182 raste gati të njëjta dhe duam të kemi informacione më shumë në lidhje me këtë rast.

Nehat Idrizi, tha se edhe ne si përfaqësues të institucioneve e kemi ndjekur me vëmendje rastin në fjalë. Dua të theksojë se ky rast asnjëherë më parë nuk është trajtuar në institucionet gjyqësore, përkatësisht në gjykata, prandaj si çështje parimi nuk dua të komentojë rreth detajeve të rastit për shkak se është rast i ardhshëm dhe është në procedurën hetimore. Duhet të jemi të kufizuar dhe të vëmendshëm kur të deklarohejmë. Meqenëse rasti është në procedurë hetimore dhe ne si organ administrativ nuk kemi të drejtë ti komentojmë, eventualisht e kemi përgjegjësinë disiplinore nëse gjyqtari në rastin konkret bën ndonjë shkelje të kodit të etikës, atëherë rasti mund të procedohet tek ne. Përndryshe, sa i përket vendosjes meritore gjyqtarët janë të pavarur dhe çdo ndërhyrje nga ana jonë cenon parimin e pavarësisë të punës së gjyqtarëve.

Kemi pranuar të vijmë sot këtu sepse nëse fillojmë çdo rast individual ta debatojmë, atëherë krijohet një praktikë jo e mirë për neve si përfaqësues të institucioneve, por për shkak të ndjeshmërisë dhe për shkak të respektit që kemi ndaj juve si Komision, e pamë të arsyeshme të vijmë dhe të deklarohejmë brenda atyre kornizave që na lejon ligji.

Duda Balje, kryetare, tha se ne si Komision për të Drejtat e Njeriut, kemi shumë ankesa se sistemi gjyqësor ka procedura që zgjasin deri në 7 vite dhe kjo nuk është aspak mirë. Rasti për vajzën nga Drenasi ka qenë dhuna seksuale dhe institucionale sepse disa institucione kanë qenë të përziera. A kemi mundësi të kemi procedurë me të përsheptuar, sepse ky është një mesazh qysh ne si Kosovë e trajtojmë një rast.

Nehat Idrizi, theksoi se ka vonesa në disa raste, sidomos Gjykata Themelore e Prishtinës është e mbingarkuar me numrin më të madh të lëndëve dhe vonesat më së shumti janë prezentë në këtë gjykatë, por me hapat që kemi ndërmarrë, e falënderoj Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për mundësitë që na kanë dhënë që të rrisim kapacitetin me staf mbështetës për gjyqtarë. Aktualisht në nëntor të vitit të kaluar, 52 gjyqtarë pas përfundimit të trajnimit kanë filluar punën dhe të vendosin lëndë, tani kemi rekrutuar 37 gjyqtarë të rinj që kanë filluar punën por ende nuk kanë të drejtë të vendosin në mënyrë meritore për çështjet. Po ashtu, jemi duke i përfaqësuar gjyqtarët edhe me staf mbështetës. Këto vonesa që aktualisht janë prezentë në këtë gjykatë, shpresoj që nga ky vit do të tejkalohen. Në këtë rast cenohet edhe konventa evropiane dhe parimi për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Ne i kuptojmë brengat e qytetarëve, por nganjëherë rastet zvarriten pa ndonjë arsye praktike apo bindëse.

Bahri Hyseni, tha se rasti për të cilin po flasim i takon një konfidence që nuk duhet të mbahet në publik. Është rast me një të mitur. Nëse duhet të bisedohet për rastin, atëherë duhet të bisedohet me dyer të mbyllura për shkak se ashtu e kërkon Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi Penal i Kosovës. Si institucion kemi vepruar menjëherë, siç veprojmë edhe në rastet tjera. Ky

rast është bërë medial, por në Kosovë ka pas edhe raste të tjera të cilat janë trajtuar, janë dënuar, janë arrestuar. Siç e dini, kemi pasur edhe dënime madje edhe shumë të rënda. I kemi lëshuar dy komunikata për të cilat publiku është në njohuri, tani për shkak të dyshimit të bazuar kemi të arrestuar 3 persona. Ndaj dyve është caktuar paraburgimi nga gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa për njërin është caktuar arresti shtëpiak. Meqenëse rasti është në procedurë penale, do të vazhdojmë me të gjitha procedurat, por pa dhënë detaje, sepse është në procedurë penale dhe çdo fjalë që do ta nxjerrim këtu do të ndikojë në procesin e hetimit, duke e ditur faktin se edhe ne si Këshill Prokurorial, si organ administrativ, nuk kemi drejtpërdrejt qasje në lëndën e prokurorit dhe gjyqtarit, por marrim informata vetëm në rastet kur ato bëhen subjekt i trajtimit, qoftë ndonjë gjyqtarë apo prokurorë, por megjithatë për shkak të shqetësimit do t'ju mbajmë të njoftuar për çdo veprim që marrin. Secili që ka rënë ndesh në dispozitat ligjore, ka neglizhuar detyrën e vet, pas rezultateve përfundimtare të hetimit do të marrë dënim të merituar, jo vetëm për këtë rast, por për çdo rast i cili është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale.

Teuta Haxhiu, pyeti se çka i mungon sistemit gjyqësor apo prokurorial të Kosovës, në mënyrë që të parandalohen apo thjesht të vetëdijesohen me dënime. Në qoftë se mungon diçka na thuani, në mënyrë që ne ta bëjmë një hap para që të mos ndodhin më raste të tilla. Janë lidhur tri institucione, që në të vërtetë na kanë bërë të ndihemi keq. Në radhë të parë shkolla, pastaj policia, pa dashtë asnjëherë të vetme me i përgjegjësuar gjërat sepse kudo ka raste individuale, pra e kemi një polici që është shembull, mirëpo, njerëzit e tillë në cilindo institucion duhet ta kenë dënimin merituar dhe mos ta njollosin gjithë sistemin.

Mirjeta Kalludra, pyeti se a ka statistika për rastet e dhunimit për 3 vitet e fundit. Sa raste të dhunimit janë ndaj të miturave. A është në rritje ky numër dhe a duhet të rriten dënimet për vepra të tilla. Po ashtu, në media është raportuar se kanë kaluar kufirin e mitura me personin në fjalë, me policin. Si është e mundur të ndodhë një gjë e tillë? Këtu kemi dështim të policisë, kemi mungesë të kontrollit të qytetarëve në kufi. I bëj thirrje prokurorisë dhe policisë që të marrin masa kundër këtyre personave, të cilët kanë qenë në detyrë, kur e mitura dhe polici kanë kaluar kufirin. Këta kryerës të veprave a kanë qenë persona zyrtarë, të cilët kanë keqpërdorë detyrën e tyre, siç ka ndodhur rasti me mësuesin në Drenas, pjestari i FSK-së në Gjilan, e shumë raste të tjera, të cilat po paraqiten. Besoj se ka edhe shumë raste të tjera, ndërsa falënderoi mediat, të cilat tha, kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe.

Lirije Kajtazi, tha se ne ju kemi vizituar kur e kemi monitoruar Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje. E kemi parë se është brengë edhe e juaj mosfunksionimi i ligjit në shumë raste dhe mosefikasiteti i gjyqësisë dhe i prokurorisë. Institucioni i Avokatit të Popullit në çdo raport të vetin raporton që ka lëndë 7 vite pa u zgjidhur. A është bërë ndonjëherë një statistikë, pse po tërhiqen palët dhe po vidhen provat në vendet e dëshmitëve, po riciklohet droga dhe po del në shitje. Të gjitha këto janë edhe shqetësim yni dhe na interesojnë sot me i shpalos për sistemet të cilat ju i mbuloni.

Shemsi Sylja, pyeti pse u mbyllën hetimet kur vajza denoncoi arsimtarin? Ku ka arritur lënda, dhe kur është mbyllur? A ka pasur ekzaminim të vajzës, a është thirr ndonjë dëshmitar tjetër a ka qenë vetëm arsimtari? Në këto raste, si zbatohen konventat ndërkombëtare për gjykime të tilla? A keni edukim apo shkollim enkas të programeve në fushën e abuzimeve të dhunës seksuale ndaj gjyqtarëve, dhe çfarë përgatitje kanë për këto raste sidomos Gjykata Themelore? Çfarë jeni duke bërë tash kur çështja është e ndjeshme por edhe për rastet e tjera?

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se shqetësimi është i përbashkët. Në ditët e fundit jemi marrë vetëm me një rast, por ka edhe shumë raste të tjera. Para 10 ditësh kishim rastin e Gjakovës pedofilizëm me 27 nxënës edhe më të vegjël dhe nuk mbajtëm seancë dhe nuk ju ftuam as juve që të raportoni por sido që të jetë, mirë që tani jeni këtu dhe të bashkëbisedojmë. Ne si deputetë nuk kemi të drejtë të interferojmë as në sistemin prokurorial as në sistemin gjyqësor, por shqetësimi i përbashkët yni është që ta gjejmë zgjidhjen e përgjithshme në një nivel vendi si në Drenas, Gjakovë, Gjilan dhe kudo tjetër që ndodhë. Ti gjejmë masat preventive për parandalim. Pyetja ime është tek heshtja e hetimeve tek prokuroria e Drenasit. Ajo çka unë dua të di, i mituri duhet të ketë shoqërues prindin po ashtu duhet të jetë i pranishëm dhe punëtori social apo psikologu klinik. A ka qenë i pranishëm psikologu klinik gjatë intervistimit të të miturës, për të parë nga afër se a ka presion që ajo ta tërheq lëndën, ose a ka ndonjë element tjetër që e ka shtyrë të tërheq lëndën. Numri i shtuar i gjyqtarëve a ka reflektuar që të ulet numri i lëndëve.

Bahri Hyseni, tha se prokurori i shtetit është i pavarur në punën e vet. Në momentin kur e merr një kallëzim penal, ai ka mundësi ta trajtojë atë dhe nëse gjen prova e fillon procedurën penale, që do të thotë, nxjerr një aktvendim për fillim të hetimit. Në momentin kur nxirret vendimi për hetim, zyrtarisht rasti ka filluar dhe është proceduar komplet konfidencial sepse mund të ketë masa të ndryshme, mund të ketë masa stimulime të ndryshme. Në rastin konkret prokurori i rastit, e ka marrë rastin e ka trajtuar dhe ka vendosur ta pushojë hetimin. Tek të miturit nuk ka mundësi të merret deklarata, pa qenë i pranishëm përfaqësuesi ligjor apo avokati. Lënda është në hetim dhe sipas legjislacionit në fuqi, duhet të zhvillohet procedurë disiplinore administrative e performancës, në mënyrë që të vijmë deri te konstatimi.

Rastet trajtohen me urgjencë. Për çdo rast që ka të bëjë me ngacmimet seksuale, me dhunime është çështje e urgjencës, nuk ka mundësi pushimi, edhe në rastin konkret nuk ka pushuar. Si janë zhvilluar procedurat, varet edhe prej dëshmitarëve. Pas hetimeve që do të vazhdojnë përfundimet e kësaj procedure penale do të dalin me komunikatë dhe do ta kuptoni shumë qartë se nuk jemi duke fshehur asgjë.

Çështja është te prokurori dhe neve duhet të na vijë zyrtarisht një shënim sepse prokuroria e shtetit ka një arkiv, i cili kontrollohet dhe pastaj çdo gjë vjen dhe ne marrim masa. Kemi shumë masa që i aplikojmë, por janë të ndaluara për shkak të ligjit të bëhen publike, që të ruhet imazhi i personit sepse mund të ketë gabime, mirëpo, do të veprojmë.

Ne do të vazhdojmë ta trajtojmë rastin ashtu siç e kërkon Kodi i Procedurës Penale dhe për çdo veprim tonin do të lëshojmë komunikatë për opinion, aq sa na lejohet sepse edhe ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në punën e prokurorit.

Ju i keni nxjerrë ligjet bazike mbi të cilat veprojmë, nuk presin lëndë në prokurori.

Në vitin 2013-2014, kemi pasur shumë lëndë, por tani më nuk presin, rastet e dhunës në familje. Rastet e ngacmimit seksual janë me prioritet të veçantë dhe ne i kemi në kuadër të veprave penale, kurse ato i bëjmë publike në ueb faqen e prokurorisë së shtetit.

Legjislacioni ekziston dhe në ndryshimet e reja të Kodit Penal, e kemi futur edhe vepër të veçantë ngacmimit seksual dhe konsideroj që kemi bazë të mjaftueshme ligjore, kemi prokurorë të mjaftueshëm, rastet nuk janë duke u vonuar. Diku 75 mijë raste penale janë trajtuar në vitin 2018. Preventivë bëjmë ne si prokurorë, i angazhojmë prokurorët të mbajnë ligjërimi të veçanta në shkolla dhe këtë e kemi në planin e punës, veprimet, qoftë kur janë të interesuar institute të ndryshme që kërkojnë dhe ajo që është e veçantë për rastet e ngacmimeve seksuale, sidomos për të miturit, ne kemi edhe prokuror të specializuar.

Nehat Idrizi, tha se numrin më të madh të gjyqtarëve e kemi caktuar tek Gjykata Themelore në Prishtinë, në mënyrë që proceset gjyqësore të mos vonohen me vite të tëra. I kemi të dhënat sa lëndë janë trajtuar, por për 3 vite duhet të merret raporti nga shërbimet e statistikave. Sa i përket edukimit, gjyqtarët dhe prokurorët bëjnë trajnime në akademinë e hetuesisë rreth dhunës dhe rreth barazisë gjinore. Çdo gjyqtarë që është i interesuar për të ndjekur trajnimin, Akademia e Hetuesisë harton planin për trajnim në lëmin përkatëse.

Kam marrë raportin edhe nga Akademia e Hetuesisë për pjesëmarrësit që kanë qenë në trajnim, sa i përket përgatitjes së gjyqtarëve, duhet të ketë 3 vite përvojë pune, provimi i jurisprudencës dhe kriteret tjera që duhet ti plotësojnë, sa i përket çështjeve kur janë në pyetje të miturit, caktohen gjyqtarët të cilët merren vetëm me këto lëndë. Nga 400 mijë lëndë, që i kemi pasur në vitin 2017, tani kemi zbritur numrin në 265 mijë lëndë. Me ndihmën e Ambasadës Amerikane, Gjykata Supreme ka ofruar një udhëzues të unifikimit të politikës drejtshkimore, i cili do t'ju shërbejë gjyqtarëve që ndaj kryerësve të veprave penale të shqiptohen dënimet meritore. Komisioni disiplinor në vitin 2017, në procedurë ndaj 8 gjyqtarëve, janë marrë masa disiplinore. Komisioni për vlerësim të performancës nga viti i kaluar është shumë më aktiv. Çdo vit, 1/3 e gjyqtarëve i nënshtrohen vlerësimit të performancës.

Kryetarja, tha se dua të besojë që jemi në rrugë të mirë, dhe që lëndët të përfundojnë në kohë sa më të shkurtë dhe dënimi të bëhet ashtu siç e parasheh ligji.

2. Të ndryshme

Teuta Haxhiu, ngriti shqetësimin rreth rastit të mospagesës së ish- të burgosurve politikë. Kemi marrë shkresa nga ta ku theksojnë se nuk u është bërë pagesa dhe kërkoi që në emër të kryetares së Komisionit, ti drejtohet një kërkesë Komisionit Qeveritar për verifikimin e statusit të ish- të burgosurve politikë, lidhur më këto çështje.

Komisioni vendosi që ti drejtohet Komisionit Qeveritar, për verifikimin e statusit të ish- të burgosurve politikë, që të na informojnë rreth këtij shqetësimi.

Komisioni u informua edhe në lidhje me detajet për organizimin e Punëtorisë në Durrës për shqyrtimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, më 22-26 shkurt 2019.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje